



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), më datë 05.05, 06.05 dhe 07.05.2014, realizoi vizitë për rikontroll në ENK “Idrizovë”. MPN-ja këtë vizitë e realizoi në shoqërimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, përkatësisht me Shoqërinë e Psikiatërve, si dhe me Shoqërinë e Foreznicëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore, në bazë të nënshkrimit të Memorandumit për Bashkëpunim.

Vizita e Burgut u zbatua në disa hapa. Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional fillimisht zhvilloi bisedë me drejtorin dhe personat kompetentë të Burgut, ndërsa më pas, duke u ndarë në dy ekipe, zbatoi këqyrje në dhomat e izolimit, në stacionar, zbatoi këqyrje në Repartin e mbyllur, në krahun e pestë dhe të tetë, Repartin “shkollarët”, Repartin e pranimit, Repartin gjysmë të hapur, Repartin e hapur, Repartin e femrave, Pavijonin D dhe ish-Repartin e pranimit (Pavijoni E). Gjatë vizitës u zbatua edhe këqyrja mbi Librin e ankesave dhe parashtrësive kundër personave zyrtarë, këqyrja mbi disa dosje dhe disa kartonë shëndetësorë.

Në ditën e vizitës ishin të vendosur 1570 persona, me ç’rast u konstatua mbipopullimi i kapaciteteve, si dhe mospërbushja e standardeve vendase dhe ndërkombëtare për vendosjen e personave të privuar nga liria. Për shkak të kushteve shqetësuese të disa reparteve, MPN-ja paraqiti kërkesë për ndërmarrjen urgjente të masave. Gjithashtu, përkujtoi se Rregullat Evropiane të Burgjeve kërkojnë që: “për kushtet e vendosjes të të burgosurve, veçanërisht për ambientet e gjumit, doemos duhet të mbahet llogari për dinjitetin e njeriut dhe sa më shumë të jetë e mundur të respektohet privatësia dhe të përmbushen kërkesat për ruajtjen e shëndetit dhe higjienës, duke mbajtur llogari për kushtet klimatike dhe sidomos për sipërfaqen e dyshemesë, sasinë e ajrit, ndriçimin, ngrohjen dhe ventilimin”.

Në kërkesën deri te ENK “Idrizovë” për ndërmarrjen urgjente të masave u sugjerua se është e nevojshme që për çdo person të dënuar të sigurohet krevat me dyshek, ndërsa dyshekët e vjetër menjëherë të zëvendësohen me të rinj dhe të ndërrohet rregullisht shtroja e papastër, si dhe personat e vendosur në Repartin e pranimit, pas klasifikimit, të dërgohen menjëherë në repartet përkatëse, për shkak të përmbushjes së qëllimit të Repartit të pranimit, si dhe zvogëlimit të mundësisë për përhapjen e infeksioneve kriminogjene.

Në drejtim të gjendjeve të hasura u kërkuar edhe mbikëqyrja e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve, e cila e njoftoi Avokatin e Popullit se është dhënë sugjerimi deri te Drejtoria e Burgut për sigurimin e kushteve të qëndrimit, vendosjes dhe higjienës së personave të dënuar në Repartin e pranimit. Pas mbikëqyrjes së zbatuar nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, MPN-ja u informua se Projekti për rekonstrukcionin e INK në RM zbatohet dhe se janë ndërmarrë aktivitete për ndërtimin dhe rekonstrukcionin e ENK “Idrizovë”. Kanë filluar aktivitetet ndërtimore të objekteve në fazën e parë të ndërtimit të institucionit, me ç’rast ka filluar shembja e objekteve të vjetër dhe ndërtimi i objektit të ri në pjesën e Repartit të hapur dhe gjysmë të hapur, si dhe intervenimet e tjera ndërtimore. Në mënyrë shtesë, nuk

lejohen mjete për rinovim (Repartin e “Shkollarëve” dhe stacionarin e institucionit), duke e marrë parasysh se në vitin 2015 do të fillohet me shembjen e objekteve ekzistuese të cilët nuk i plotësojnë standardet e dëshiruara. Sipas informatës së DES pritet që rikonstruksioni i plotë të kryhet në vitin 2018.

Në bisedë me personat e dënuar, MPN-ja pranoi ankesa për përdorimin e tepërt të forcës. Informatat të cilat Mekanizmi Parandalues Nacional i pranoi gjatë kohës së vizitës, vënë në pah se masat e ENK “Idrizovë” nuk janë mjaftueshëm efikase për parandalimin ose eliminimin e çfarëdo qoftë rreziku nga dukuria e torturës ose trajtimi brutal dhe johuman.

MPN-ja gjatë vizitës për rikontroll pranoi një numër të madh të ankesave të cilat kanë të bëjnë me cilësinë dhe sasinë e ushqimit, si dhe se nuk ka regjim të posaçëm të ushqimit për personat e dënuar të cilët kanë sëmundje specifike.

Pjesa më e madhe e personave të dënuar, nuk janë të angazhuar me punë dhe kjo ndikon mbi procesin e risocializimit. Edhe më tej ka ankesa për dhunë, si dhe për korrupsion nga ana e Sektorit të sigurimit.

Duke e pasur parasysh se me ndryshimet e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve është përcaktuar që mbrojtja shëndetësore të bëhet nga punonjësit shëndetësorë të institucioneve publike, të cilët ushtrojnë mbrojtje primare shëndetësore, në praktikë kjo dispozitë është e vështirë për t’u aplikuar, ndërsa në mënyrë plotësuese gratë e dënuara u ankuan se për një periudhë më të gjatë kohore nuk janë dërguar për kontrolle gjinekologjike.

Si rezultat i vizitës së realizuar, Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional përgatiti raport të veçantë në të cilin e konstatoi shkallën e rekomandimeve të zbatuara, si dhe dha sugjerime përkatëse, të cilat ia adresoi Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe ENK “Idrizovë.